



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E GJAKOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____/2025

Datë: 21.05.2025

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe duke u mbështetur në dispozitat e Statutit të Komunës së Gjakovës të miratuar me datë 28.12.2022, në mbledhjen e mbajtur me datë 21.05.2025 pas diskutimit lidhur me pikën 4 të rendit të ditës: Propozim vendim për këmbimin pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Zef Mula, e miratoi këtë:

V E N D I M

Për

Këmbimin e Pronës Komunale

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton vendimin për Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale me pronën private në pronësi të Zef Mula, Nikoll Mula 5/16, dhe Gjon Mula 11/16.

2. Pronat e paluajtshme Komunale që do të ipet në këmbim, ka këto karakteristika si vijon:

2.1. Pjesë e Parcelës Kadastrale nr. P-70705029-00078-1, Zona Kadastrale Gjakovë Qytet evidentuar në Pronësi PSH. Shoqata e Zejtareve, sipas dokumenteve të Planifikimit Hapësinor ka destinimin si Zonë e Shërbimit ZSH9 Shërbim i Komitetit – Zjarrfikësit dhe pjesërisht rrugë.

2.2 Prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesë e parcelës kadastrale P-70705029-00077-0 dhe P-70705029-05846-0 Zona Kadastrale Gjakovë Qytet, në pronësi private të Zef Mula, Nikoll Mula 5/16 dhe Gjon Mula 11/16, sipas dokumenteve të Planifikimit Hapësinor ka destinimin si Zonë e banimit/ZB4 Banim Kolektiv- Banim me shumë njësi.

3. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme është realizimi i dokumenteve të Planifikimit Hapësinor, si dhe për shkak të gjendjes faktike, pjesa e parcelës që do të këmbehet do të shfrytëzohet si rrugë/trotuar ekzistuese.

4. Pjesa e sipërfaqes që do të këmbehet është 348m² sipas dokumentacionit të bashkangjitur si dhe raportit të vlerësimit të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Mënyra dhe kushtet e Këmbimit të Pronës së Paluajtshme do të përcaktohen me kontratë e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe Pronarit të paluajtshmërisë që do të këmbëhet.

6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .

7. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
- Arkivit



Arbenesha Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës